

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË PODUJEVË** : - **Departamenti i përgjithshëm – divizioni civil** : me gjyqtarin Bujar Muzaqi dhe procesmbajtësen Afërdita Ejupi, duke vendosur në çështjen juridiko civile të paditësit A.A. me vendbanim në Rr. “...” nr..., Komuna P. të cilin e përfaqëson e autorizuar A.Z., Juriste me vendbanim në Rr. “...”, S., Komuna P., me autorizim, kundër të paditurve Sh.A.Rr. me vendbanim në Rr. “...” nr..., Komuna P. dhe N.B.K. me vendbanim në Rr. “...” nr..., Komuna P. për kompensim dëmi, në vlerë prej 435,50 €, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në praninë e paditësit, të autorizuarit të paditësit dhe të paditurit të dytë N. K. e në mungesë të paditurit të parë Sh.Rr., me dt.06.01.2017 mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**APROVOHET PJESËRISHT** kërkesëpadija e paditësit A.A. me vendbanim në Rr. “...” nr..., Komuna P. **SI E BAZUAR** dhe **DETYROHEN** të paditurit Sh.A.Rr. me vendbanim në Rr. “...” nr..., Komuna P., dhe N.B.K. me vendbanim në Rr. “...” nr..., Komuna P. që paditësit A.A., t’ia kompensojnë në mënyrë solidare dëmin material në vlerë prej 435,50 €uro e të gjitha këto me kamatë vjetore siç e paguajnë Bankat afariste në Republikën e Kosovës kursimtarëve të vet në mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 36 €uro, në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

**REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa e paditësit sa i përket kamatës që kamata e rregullt të jetë 8% vjetore dhe kërkesa për kompensimin e fitimit të humbur nga data 15.09.2003 deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi.

## **A r s y e t i m**

Paditësi A.A. nga P., rr. “...” nr..., në këtë Gjykatë ka ushtruar padi me të cilën ka kërkuar që të detyrojë të paditurit Sh.A.Rr. me vendbanim në Rr. “...” nr..., Komuna P. dhe N.B.K. me vendbanim në Rr. “...” nr..., Komuna P. t’ia kompensojnë dëmin në vlerë prej 435,50 €uro.

Paditësi dhe e autorizuarja e tij A.Z., si në padi, precizim të padisë seancë kryesore si dhe fjalën përfundimtare gjatë shqyrtimit kryesor me dt.06.01.2017, ka deklaruar se me datën 15.09.2001 i padituri i parë Sh.Rr. ka vjedhur gjësende në vlerë prej 435,50 €uro të cilat sende ia ka shitur të paditurit të dytë N.K. me datën 16.09.2001, i cili e ka ditur se sendet janë të vjedhura pas i që i ka ble me çmim më të ulët se çmimi real i tyre. Lidhur me këtë çështje është zhvilluar procedura penale pranë

Gjykatës Komunale në Podujevë dhe me Aktgjykimin P.nr.177/2002 me të cilin të paditurit janë shpallur fajtorë dhe dënuar sipas ligjit, ndërsa paditësi është udhëzuar në kontest për realizimin e kërkesës së tij. Me këtë paditësi ka pësuar dëme materiale si pasojë e dëmtimit të pasurisë së tij-lokalit afarist DPT "F...", në të cilin e ka zhvilluar biznesin e produkteve sanitare dhe me atë rast i është shkaktuar dëm material në shumë prej 435,50 € dhe atë shuma prej; bojlerë 80 €, tushë bateri 60 €, bateria automatike 60 €, VC guacë 30 €, bateria të thjeshta 40 €, selikona 30 €, shkuma 20 €, ngjyra për dyer 25 € dhe gjëra tjera të ndryshme 90 €.

Në seancën e dt.06.01.2017 e autorizuara e paditësit ka propozuar që seanca të mbahet në mungesë të paditurit të parë Sh.Rr.. Më tej ka deklaruar se sa i përket propozimit të cilin e kemi paraqit me precizimin e kërkesëpadisë të dorëzuar në gjykatë me dt.15.12.2016, e tërheqim propozimin për caktimin e ekspertit lidhur me fitimin e humbur, ndërsa në fjalën përfundimtare ka shtuar se qëndroj prapa padisë dhe precizimit të kërkesëpadisë dhe kërkoj nga gjykata që ta aprovoj kërkesën dhe të merr Aktgjykim që paditësit t'i kompensohet dëmi dhe meqë i padituri i dytë siguron të ardhura e lusim që paditësit në afat të rregullt gjyqësorë të ia paguan demin paditësit.

Po ashtu i padituri i parë Sh.Rr. është ftuar disa herë për seancë, ndërsa për seancën e dt.06.01.2017 ishte ftuar me ftesën e dt.08.12.2016 të cilën e ka pranuar A.Rr. me dt.27.12.2016, por nuk ka prezantuar në seancë dhe nuk e ka arsyetuar mungesën e tij në asnjë mënyrë.

Në një gjendje të tillë e autorizuara e paditësit i ka propozuar gjykatës që të mbahet shqyrtimi kryesorë në mungesë të të paditurit të parë Sh.Rr., të cilin propozim gjykata e aprovojë me aktvendim e saj në procesverbal konform nenit 423.4 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, mbajti shqyrtimin kryesorë në mungesë të të paditurit të parë pasi që e vlerësojë se nuk ka nevojë që të njëjtin ta ftoj edhe më tej meqenëse shihet qarti se refuzon që ti përgjigjet ftesës së gjykatës, si dhe duke u bazuar në nenin 111.1 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se : ***“ Po që se personi të cilit duhet bërë dorëzimi i shkresës nuk gjendet në banesën e vet, dorëzimi bëhet duke iu dhënë shkresa ndonjë anëtar i rritur të familjes së tij, i cili ka për detyrë ta marrë shkresën në dorëzim...”***.

I padituri i parë Sh.Rr., në përgjigje në padi të ushtruar me shkrim pranë kësaj gjykate me datën 24.06.2015, ka theksuar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar me arsyetim se nuk ka kurrfarë detyrimi ndaj të paditurit, sepse i njëjti nuk ka marrë kurrfarë objekti-sendi për të cilin pretendon paditësi dhe se rrethanat për të cilat pretendon paditësi do ti sqaroj në shqyrtimin kryesor. Andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditësit A.A. dhe paditësi ti paguaj shpenzimet e procedurës.

I padituri i dytë N.K., në përgjigje në padi dhe precizim të padisë, seancë dhe fjalën përfundimtare të shqyrtimit kryesor ka deklaruar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar me arsyetim se unë edhe në Gjykatën

Komunale në Podujevë e kam refuzuar dhe mohuar në tërësi rastin në fjalë. Unë as sot nuk e njoh atë person i cili ishte në aktakuzë. Më tej ka shtuar se në vitin 2000 apo në 2001 e kam hap një lokal me një shok timin në emrin tim në të cilin lokal kemi shit material elektrik më të cilin shok kemi qenë bashkëpronar të ati biznesi, dhe në atë kohë na kemi marr mall, i cili mall na e kanë sjell me kombi nga Prishtina, nga Presheva, dhe mu nuk me kujtohet se kam marr mall prej të paditurit të parë, po ashtu e kundërshtoj padinë dhe kërkesëpadisë e paditësit në tërësi, dhe lidhure me këtë lëndë nuk mbaj kurrfarë përgjegjësie. Ndërsa në fjalën përfundimtare shtoi se e kundërshtoj në tërësi padinë e paditësit.

Në procedurën e provave gjykata bëri leximin dhe administrimin e këtyre provave dhe atë: u lexua Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Podujevë me nr.P.nr.177/2002 dt.15.10.2003, Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë AP nn.30/2004 dt.16.12.2005, Raporti fillestar i rastit i lëshuar nga Polici hetues me dt.26.12.2001, ku këtij raporti i është bashkangjitur edhe një faqe me listën e gjerave të munguara me numër të rastit 01TF-1574, Fletë dërgesa me nr.307/01dt 30.07.2001, Fletë dërgesa me nr.007 dt.05.07.2001, Fatura me nr.0137/01 dt.25.07.2001, Fatura tatimor 08 2001 dt.04.12.2000, Fatura me 3108/2001 dt.31.08.2001, Fatura 1508/2001 dt.15.08.2001, si dhe lexohen provat tjera në shkresën e lëndës.

Pas administrimit të provave një nga një e të gjithave së bashku konform nenit 8 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, gjykata gjeti se padia dhe kërkesëpadia e paditësit, pjesërisht është e bazuar dhe si të tillë e aprovojë ashtu siç është cekur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Megjenëse është konstatuar fakti se i padituri i parë Sh.A.Rr. me vendbanim në Rr. “...” nr..., Komuna P. i ka shkaktuar dëm paditësit duke hyrë në shitoren “F...”, në rrugën “...” në P., dhe marrë një sasi të sendeve të teknikës së bardhë, me qëllim që vetes ti sjell përfitim pasurorë të kundërligjshëm, ky fakt vërtetohet me aktgjykimin penal P.nr.177/2002 të dt.15.10.2003 i formës së prerë me dt.16.12.2005, me të cilin i padituri është shpallur fajtorë dhe është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 muajsh, si dhe thëniet e paditësit në padi.

Gjithashtu është konstatuar fakti se i padituri i dytë N.B.K. me vendbanim në Rr. “...” nr..., Komuna P. i ka shkaktuar dëm paditësit duke vënë në dorë sendet e teknikës së bardhë për të cilat e ka ditur se janë vjedhur nga i pandehuri-tani i padituri i parë Sh.Rr. në shitoren “F...”, ky fakt vërtetohet me aktgjykimin penal P.nr.177/2002 të dt.15.10.2003 i formës së prerë me dt.16.12.2005, me të cilin i padituri është shpallur fajtorë dhe është dënuar me dënim me kusht, si dhe thëniet e paditësit në padi.

Nuk është kontestues fakti se dëmi i shkaktuar paditësit është në shumën prej 435,50€, duke hapur derën e lokalit të tij dhe marrë një sasi të sendeve të teknikës së bardhë në vlerë 865, DM (435,50 €) të cilat më vonë janë dërguar në lokalin “Drita” të cilat i janë shitur pronarit N.K. në vlerë prej 270 DM. Ky fakt u vërtetua me prova materiale që gjenden në shkresa të lëndë, dhe atë Raportit fillestar të rastit të Policisë me nr.2001TF1574 dt.26.12.2001, ku këtij raporti i është bashkangjitur edhe shkresa ku

nga Policia janë konstatuar se në ditën e shkaktimit të dëmit se çka ka munguar në lokalin e paditësit si p.sh Bojler Gorenje 80 litrave në vlerë 150 DM, tri bateria automatike të ujit në vlerë 180 DM, tri bateria të llavabos në vlerë 180 DM, katër bateria të thjeshta të ujit 100 DM, dy ventilua në vlerë 32 DM, gjashtë ventilla 1 coll 54 DM, korpa të hidroforit të mëdha në vlerë 24 DM, korpa të hidroforit të vogla në vlerë 27 DM, gjysëm lidhse 2 copa në vlerë 36 DM, diktuna 100 në vlerë 25 DM, shërben për dritare 72 DM, silikon 40 DM, e të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 865 DM, gjegj. 435,50 Euro, ky fakt u vërtetua edhe në faturat që gjinden në shkresat e lëndës që e vërtetojnë lartësinë e këtyre shumave, si dhe bazuar në Aktgjykim e Gjykatës Komunale në Podujevë P.nr.177/02 dt.15.10.2003, i vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë AP.nr.30/2004.

Meqenëse të paditurit i kanë shkaktuar dëm paditësit dhe kjo rrethanë u vërtetua me prova në procedurë, atëherë gjykata duke u bazuar në nenin 154.1 të Ligjit nr.3/3/1978 mbi Mardhëniet e Detyrimeve, i cili thotë se pala e paditur është e obliguar t'ia kompensoj dëmin palës së dëmtuar me vepër penale në këtë rast në shumën prej 435,50€.

Në Nenin 154.1 të Ligjit nr.3/3/1978 mbi Mardhëniet e Detyrimeve, në mënyrë decisive thuhet se : **“Kush tjetrit i shkaktonte dëm e ka për detyrë t'i kompensojë në qoftë se nuk e provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij.”** Po t'i referohemi nenit 158 të Ligjit nr.3/3/1978 mbi Mardhëniet e Detyrimeve, ku bëhet fjalë për ekzistimin e fajësisë atëherë ky fakt vërtetohet se tek të paditurit ekziston fajësia sipas aktgjyimit penal të formës së prerë të ish Gjykatës Komunale Podujevë P.nr.177/02 të dt.15.10.2003, ku janë shpallur fajtorë të paditurit për veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 të KPK-së, respektivisht i padituri i dytë për veprën penale Pranim i mallrave të vjedhura nga neni 272 par.1 të KPK, dhe janë dënuar me dënim me burgim, gjegjësisht me dënim me kusht i padituri i dytë.

Se palës paditëse i takon e drejta në kompensimin e dëmit kjo kërkesë bazohet dhe në nenin 185 par.2, 3 dhe 4 të Ligjit nr.3/3/1978 mbi Mardhëniet e Detyrimeve.

Gjykata në këtë rast ka lidhshmëri me aktgjykimin penal ku të paditurit janë shpallur fajtorë kjo më së miri konstatohet në nenin 14 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, ku në këtë nen në mënyrë decisive thuhet se **“Në procedurën kontestimore, gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor”**.

Prandaj pasi që të paditurit janë shpallur fajtorë me aktgjykim të formës së prerë dhe është konstatuar dëmi i shkaktuar paditësit nga të paditurit në shumë prej 435,50 Euro, atëherë gjykata i obligoi ata që t'ia paguajnë dëmin në mënyrë solidare paditësit konform nenit 206 par.4 të Ligjit nr.3/3/1978 mbi Mardhëniet e Detyrimeve në të cilin nen ndër të tjera thuhet se : **“Kur nuk ka dyshim se dëmin e ka shkaktuar ndonjë nga dy ose më tepër persona të caktuar të cilët në ndonjë mënyrë janë të**

***ndërlidhura midis tyre, ndërsa nuk mund të përcaktohet se cili prej tyre e ka shkaktuar dëmin, këta persona përgjigjen solidarisht”.***

Por gjykata nuk gjeti se kërkesa në padi sa i përket fitimit të humbur nga data 15.09.2003 deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, të jetë e bazuar në prova, ngase kjo kërkesë nuk u bë e bazuar me prova nga pala paditëse konform nenit 7.1 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, i cili e obligon palën paditëse të paraqes prova për ta bërë të bazuar kërkesën duke u mbështetur në prova atë dhe gjykata në mungesë të bazës juridike nuk ju aprovua kërkesa e tij si e bazuar por e njëjta ju refuzua si e pavërtetuar dhe e pa mbështetur në prova kërkesa e tij për fitimin e humbur nga data 15.09.2003.

Kamata iu llogarit nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit dt.06.01.2017 kur u vërtetua dëmi dhe shuma e tij deri në pagesën përfundimtare konform nenit 277 të Ligjit nr.3/3/1978 mbi Mardhëniet e Detyrimeve si ligj në fuqi kur është krijuar raporti detyrimor, duke iu refuzuar kërkesa e palës paditëse që kamata të jetë 8%, duke llogaritur prej datës 15.09.2001 deri në pagesën përfundimtare dhe e refuzoi si të pabazuar.

Andaj gjykata në këtë gjendje të tillë të vërtetuar me provat materiale në procedurë dhe me zbatimin e dispozitave të cekura më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore gjykata vendosi konform neneve 449.1, 452.1 dhe 453.1 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, dhe i detyroj të paditurit t’ia paguajnë në mënyrë solidare shumën prej 36 Euro në emër të taksës gjyqësore, për padi 15 Euro dhe për aktgjykim 15 Euro, si dhe shumën prej 6 Euro, për kopjet e provave.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
DEGA NË PODUJEVË  
C.nr.565/2003 me dt.06.01.2017**

**Gjyqtari,  
Bujar Muzaqi**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nga palët, e nëpërmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.